



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7060 Prot.

Roskovec, më 28, 07 2022

VENDIM

NR 49. DATË 27. 07. 2022

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN QERSHOR 2022”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 29.06.2022, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Qershor 2022.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: www.bashkiaroskovec.gov.al

Nr. 6399/1 Prot.

Roskovec, më 01.07.2022

Procesverbal Nr.7

-I mbajtur sot, date 29.06.2022, ora 12⁰⁰, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Maj dhe mbledhjes jashtë radhe 1 Qershor 2022.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak për muajin Maj dhe mbledhjes jashtë radhe 1 Qershor 2022.
4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Maj 2021.
5. Për pjesmarrjen e Bashkisë Roskovec në subjekte me kompetenca të përbashkëta me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.
6. Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2021.
7. Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022.
8. Për miratimin e dokumentit të parë për Programin Buxhetor Afatmesëm PBA 2023-2025.
9. Për anulim të pjesshëm të VKB Nr.34 datë 24.05.2022 “Për miratimin e ndryshimeve në Vendimin Nr.103 datë 24.12.2021 “Për miratimin e buxhetit dhe numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe Ndërmarrjeve Vartëse të Bashkisë Roskovec, për vitin 2022”.
10. Për dhënien e titujve “Qytetar Nderi” të Bashkisë Roskovec.
11. Për një ndryshim në emërtimin e rrugëve në Bashkinë Roskovec.
12. Raport i monitorimit për 4-mujorin e I për vitin 2022.
13. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes se mbledhjes: 12¹⁰

Keshilltaret prezent: A.Kola, V.Mata, E.Çepele, L.Goga, B.Çobo, D.Hoxha, A.Hazizi, V.Bakaj, A.Sheme, H.Beqiraj, B.Toska, M.Sufka.

Keshilltaret qe mungojne :Rr.Hazizi, L.Hoxha, B.Kuka, T.Kuka, K.Hyska, G.Hoxha, V.Dogani.

Prezent nga bashkia: Nenkryetaret M.Goga, K.Lushka, Dr.Juridik, Dr.Finances, P/Z/Sherbimit Social, P/Artit dhe Kultures, P/Urbanistikes, Dr.Ujesjellesit, Dr.Ardhurave Vendore.

Me plotesimin e kuorumit ,zv/kryetari hap mbledhjen.Prezent ne fillimin e mbledhjes jane 12 keshilltare.Para se te filloje me mbledhjen,zv/kryetari ben me dije se kemi disa materjale shtese per ti futur ne rendin e dites sot.Te projekt-vendimi i pikes nr.10 te rendit te dites “Per dhenien e titujve “Qytetar Nderi” do te shtojme propozimin per dhenien e titullit “Qytetar Nderi” Z.Xhevit Qerim Kodhelaj.Materjali tjetër shtese i ardhur nga administrata eshte “Raport per situaten financiare ne te cilen ndodhet Bashkia Roskovec”.Zv/kryetari Leksi Goga sqaron se ne mungese te kryetarit te keshillit per arsye shendetesore,mbledhjen do e drejtoje une sipas ligjit.I hedh ne votim materjalet shtese si me siper propozimin shtese per titull “Qytetar Nderi” dhe projektvendimin e raportit te planit te masave per daljen nga situata e veshtiresise financiare dhe miratohen unanimitisht me 12 vota pro.

1.Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i dites bashke me shtesat e bera si me siper dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro.

2.Informacion mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Maj dhe mbledhjes jashte radhe 1 Qershor 2022.

Informacioni i pregatitur nga sekretarja ka te bej me vendimet e miratuara mbledhjet e kaluara,ndarja e akteve normative dhe miratimi i tyre ne Prefektуре.

3.Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak per muajin Maj dhe mbledhjes jashte radhe 1 Qershor 2022.

Hidhen ne votim procesverbalet e mbledhjeve te kaluara dhe miratohen unanimitisht me 12 vota pro.

4.Per dhenien e Ndhimes Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-31 Maj 2022.

P/Z/Ndhimes Ekonomike Sidorela sqaron projektvendimin dhe ndryshimet qe ka pas kete muaj.Elmazi-nga muaji i pare ne kete muaj kush eshte hequr dhe pse eshte hequr?A ka shtese ne page?Sidorela-nuk kemi hequr vetem kemi shtuar dhe nuk ka shtese ne page.Bujari-keta persona do jene gjithmone apo do ndryshohen?Nenkryetari M.Goga jep sqarime ne lidhje me pyetjen.Alketi-pyet per 30 mije lekeshen e ndihmes ekonomike qe nuk i kane marr qytetaret kete muaj.Elis Apostoli jep sqarime ne lidhje me pyetjen.Hidhet ne votim projekti sipas materjalit dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro.

5. Per pjesmarrjen e Bashkise Roskovec,ne subjekte me kompetenca te perbashketa me qellim kryerjen e sherbimeve te furnizimit me uje dhe te largimit,trajtimit dhe perpunimit te ujerave te ndotura”.

Dr.Juridik E.Apostoli sqaron projekt-vendimin sipas materjalit.Do te behet nje riorganizim i sektorit te furnizimit me uje dhe trajtimit te ujerave te ndotura sipas vendimit te qeverise.Per kete duhet dhe autorizimi i Kryetares se bashkise.Maksi-ne baze te VKM eshte bere riorganizimi i ujesjellesit.Per kete gje kerkohet autorizimi i kryetares sipas materjalit qe ju eshte paraqitur.Bujari-a nuk mund te ngrejme zerin per ta menaxhuar vet ujesjellsin,pse te bashkohemi me te tjere?Maksi-qeveria e ka marr kete vendim,ne si bashki e kemi te pamundur per ta menaxhuar vet.Aleksander-perderisa eshte VKM pse e sillni ne keshill?Maksi-ne po sjellim autorizimin e kryetarit per lidhjen e marreveshjes dhe nenshkrimin e cdo akti te nevojshem.Elmazi-jam dakort me ju,por ne energjin se mbulojme dot,nuk eshte e lehte per ta mbajtur,prandaj eshte vendim qeverie dhe duhet ta miratojme.Hidhet ne votim projekti per pjesmarrjen e bashkise Roskovec ne subjekte me kompetenca te perbashketa me qellim kryerjen e sherbimeve te furnizimit me uje sipas materjalit dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro.

6.Per miratimin e raportit vjetor te konsoliduar te zbatimit te buxhetit per vitin 2021.

Dr.Finances sqaron projekt-vendimin.Sqaron me zera raportin vjetor te konsoliduar te zbatimit te buxhetit per vitin 2021.Bujari-me sa te ardhura ishim nga viti 2021?Dr.finances sqaron se ishin 41 milion,te cilat jane grand dhe te ardhurat tona te paperdorura.Hidhet ne votim raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit te buxhetit per vitin 2021 dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro.

7.Per miratim rishperndarje fondesh ndermjet programesh ne buxhetin e Bashkise Roskovec per vitin 2022.(2 projekt-vendime)

Ky projekt eshte ndare ne 2 projekt-vendime per arsye se vetem njeri eshte akt normativ qe do vej ne Prefektore dhe do i zbardhim vendimet secilin me vete.Maksi-sqaron situaten ku eshte bashkia dhe ndryshimet e paraqitura ne buxhet.Sqaron se sot jemi ne 20.4% te borxhit dhe duhet ta ruajme kete perqindje ne baze te materjalit qe ju kemi sjelle.Sqaron ndryshimet qe kane pesuar investimet ne vlerat e tyre.Sqaron edhe projektet qe do te futen ne emergjencat civile te qeverise.Kemi ulur disa zera per administraten,nuk kemi parashikuar luks per administraten,i kemi hequr dhe i kemi kaluar ne investime.Jane rritur cmimet ne zerat e materjaleve,per keto zera ne kemi parashikuar edhe keto ndryshime ne investime qe ju kemi paraqitur.Bujari-per Luarin nuk eshte parashikuar asnje investim nga bashkia per kete vit,pervec asaj nga FSHZH?Maksi-te gjitha investimet e miratuara dhe qe nuk kane ndryshim,nuk jane futur ne kete materjal.Ne po ju paraqesim vetem ndryshimet dhe investimet e reja.Eshte zhvilluar dhe mbledhja e Komisionit te Ekonomise ku u diskutuan keto ndryshime.Rruga e Kerranjakeve e ke te miratuar dhe te kaluar.Vjollca-per fshatin Mbers-Vlosh-Ngjeqar ka nje rruge qe nuk eshte perfunduar.Maksi-sqaron se do te ngrihet nje ambulance e re ne Mbers dhe qendra.Vjollca-tek beqallaret ka ngelur ngjysem,tek bakallaret ata e kane ber me leket e tyre.Maksi-ne Prefektore do te shkoje vetem vendimi qe eshte me karakter normativ,ne do e cojme por mund te ndodh qe edhe Prefektura te kete udhezimet e saj nga qeveria.Selmani sqaron zerat qe shtohen dhe pakesohen si dhe rikonstriksionin e catise se shkolles Kuman nga emergjencat civile.Sqaron ndryshimet dhe shkurtime fondi per disa investime dhe shpenzime operative dhe mirembajtjes.Hidhet ne votim projekti i rishperndarjes se fondeve ndermjet programesh ne buxhetin e vitit 2022 sipas materjalit te paraqitur dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro.Hidhet ne votim projekti per ndryshim dhe shkurtime fondesh ne buxhetin e vitit 2022 sipas materjalit te paraqitur dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro.(2 vendime)

8.Per miratimin e dokumentit te pare te PBA 2023-2025.

Dr.Finances sqaron projektin sipas materjalit te paraqitur.Ky eshte dokumenti i pare i PBA 2023-2025.Jane bere dhe degjesat publike per kete projekt.Selmani sqaron me detaje tabelat dhe zerat perkates.Hidhet ne votim miratimi i dokumentit te pare te Projekt Buxhetit Afatmesem PBA 2023-2025 dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro.

9. Për anulim të pjesshëm të VKB Nr.34 datë 24.05.2022 “Për miratimin e ndryshimeve në Vendimin Nr.103 datë 24.12.2021 “Për miratimin e buxhetit dhe numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe Ndërmarrjeve Vartëse të Bashkisë Roskovec,për vitin 2022”.

Dr.Juridik E.Apostoli sqaron ndryshimin dhe arsyen e anulimit te pjesshem te VKB Nr.34 date 24.05.2022.Aleksandri-na sqaroni arsyen pse,se ne e miratuam mbledhjen e fundit.Elisi-ne do te bejme vetem kalimin e pageses,ai punonjes nuk do te shtohet fare ne strukture si punonjesi yne.Maksi-nuk do te kete shtese punonjesi por do kalojme vetem pagen dhe sigurimet shoqerore.Hidhet ne votim anulimi i pjesshem i VKB Nr.34 date 24.05.2022 dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro.

10. Per dhenien e titullit “Qytetar Nderi”.

P/Arsimit dhe Kultures sqaron projektin dhe emrat e propozuar per dhenien e titullit ‘Qytetar Nderi’ sipas motivacioneve perkatese per secilin emer te propozuar. Maksi-sqaron se jemi ne prag te festes se 24 korrikut, eshte ngritur komisioni i cili ka shqyrtuar emrat qe ju kemi propozuar. Leksi-per z. Kristaq Prifti, ka pasur vdekje natyrale? Ana-ka pasur vdekje nga gazi. Elmazi-nuk kam kundershtrim per asnje nga emrat, por ka edhe emra te tjere qe kane kontribuar me shume. Alketi-pse mos tu japim edhe atyre qe jane gjalle dhe kane kontribuar? Maksi-ne kemi vendosur qe mos te japim per ata qe jane gjalle, se ka pasur dhe eksperiencia te keqe. Prandaj ne si komision kemi vendosur te japim propozim per tituj nderi vetem pas vdekjes. Hidhet ne votim dhenia e titullit “Qytetar Nderi” Z. Vlasi Mitrush Goga, Kristaq Tili Prifti, Riza Hamet Shehu, Qemal Yzeiri, Gani Hoxha, Haxhi Malka, Xhevit Qerim Kodhelaj sipas motivacioneve perkatese dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro dhenia e titullit per te gjitha emrat mesiper.

11. Per ndryshimin e emertimit te disa rrugeve ne Bashkine Roskovec.

Maksi-kemi paraqitur para jush rruge qe kane pasur vetem mbiemrin, u kemi shtuar edhe emrin duke mar parasysh edhe kerkesat dhe propozimet e kryetareve te fshatrave. Ju kemi paraqitur propozimin me ndryshimin e emertimit te rrugeve sipas fshatrave ne si ka qene emertimi dhe si do te behet. Nuk ka diskutime. Hidhet ne votim projekt-vendimi sipas materjalit dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro.

12. Raport i monitorimit per 4-mujorin e I per vitin 2022.

Dr. Finances sqaron materjalin. Ky eshte nje raport i monitorimit per 4-mujorin e I te vitit 2022 me anekset 1,2,5 per bashkine dhe 2 njesite e varesise. Eshte detyrim ligjor tua sjellim per dijeni keshillit. Sqaron ne menyre te detajuar tabelat e raportit. Nuk ka diskutime.

13. Per miratimin e raportit te planit te masave per daljen nga situata e veshtiresise financiare te Bashkise Roskovec.

Maksi-sqaron raportin per situaten financiare ne te cilen ndodhet bashkia Roskovec. Puna kryesore eshte e drejtorise se te ardhurave vendore, i cili duhet te mbledhi me cdo kusht detyrimet e taksave. Ne kemi propozuar nje plan masash per zbutjen e kesaj situate, dhe ju do jeni ne monitorim te vazhdueshem te kesaj situate dhe te planit te masave te marra. Ne raport jane te parashikuara masat qe do te merren per rikuperimin e problemeve financiare. Plan masash edhe per uljen e debise nga abonentet familjar dhe bizneset, dhe shtimin e arketimeve. Hidhet ne votim raporti i planit te masave per daljen nga situata e veshtiresise financiare te Bashkise Roskovec dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro.

14. Diskutime dhe komente te qytetareve.

Elmazi-shumica e qytetareve jane ne emigrim dhe nuk kane mundesi te paguajne taksen e tokes ne kohe, propozoje qe 30% i ulur te shtyhet edhe 3 muaj. Maksi-do e shqyrtojme me komisionin e ekonomise dhe me ekzekutivin per mbledhjen tjeter. Viktori-kur marrin plehrat ne makine, ato bien ne rruge perseri. Vjollca-ankesa nga qytetaret per pagesen e taksave te pastrimit, ndricimit dhe gjelberimit. Ne rast se nuk sherbehet skemi pse paguajme, vijne qytetaret ketu dhe sorollaten nga 3 dite per nje vertetim. Vjollca-ne taksen e kemi miratuar per ato rruge qe kane ndricim, jo per ato qe nuk kane. Maksi-te behet nje verifikim per ato familje ku nuk u sherbehet dhe u merret takse. Te ngrihet nje grup pune per te bere verifikimet ku sherbehet dhe ku jo. Alketi-problemi i ujesjellesit per prishjet qe kane bere ne rruge, kane hapur gropa. Maksi-nuk i vem dot gjobe pa u mbyllur kontrata, ka problematika ligjore. Alketi-kam ngritur problem per kanal in e betonit, thane do vijme ta verifikojme. Kujtim Musta qytetar nga Kurjani-kemi ber kerkesa, kemi problem me token qe quhet

Shqop ne Çerven.Kam biseduar edhe me kryetarin e fshatit,ai na con ne nje toke tjeter.Une taksen e tokes e paguaj dhe akoma nuk me eshte zgjidhur problemi.Maksi-persa i perket problemit te tokes ne Çerven eshte ngritur komisioni nga bashkia dhe eshte rindare dhe rimatur kjo toke.Mbi 90% komisioni e ka perfunduar punen,por do e mar une persiper me komisionin per ta riorganizuar edhe njehere.Qytetari z.Kujtim-problem tjeter eshte rruga Siqeca,50 m rruge eshte dhe do rere bituminoze.Problemi i ndricimit dhe gjelberimit,ku i ke?pse ti paguaj,ne skemi as kosh plehrash.Maksi-per koshin do ua sjellim qe nesar.Nuk ka me diskutime.Zv/kryetari Leksi Goga mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Kadri Hyska

